



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:108202  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05473504

**Ac.nr.8250/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.Sh., nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson N.C., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, DKA, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1676/2023, të datës 27.09.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 19.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të së paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1676/2023, i datës 27.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

*‘APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.Sh., nga Prizreni.*

*DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses F.Sh., t’ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022 dhe atë për 137 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej 274.00 € (dyqind e shtatëdhjetë e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.*

*DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 124 € (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.*''

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes të autorizuarit të saj në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të së paditurës si të bazuar, ashtu që ta ndryshoj duke e hedhë padinë e paditëses apo ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**- Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja F.Sh., ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për 137 ditë pune, për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, t'ia paguajë shumë prej 274.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, e në pajtim me nenin 152 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar pa shqyrtim kryesor të çështjes, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të së paditurës, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk ishte kontestues fakti se paditësja është e punësuar te e paditura në SHFMU “M..... L.....” në Prizren, fakt i vërtetuar nga vërtetimi i datës 14.03.2023 e lëshuar nga e paditura, po ashtu është kontestues fakti se paditësja për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datën 21.11.2022, ka qenë prezentë në vendin e punës për 137 ditë, fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.139/23 i datës 14.03.2023. Kontestuese nga e paditura ka qenë pa mundësia buxhetore e pagës së këtyre detyrimeve.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L – 212 datës 01.11.2010, përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndemjet a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata , marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit , b) në nivel të degës, c) nivel të ndërmarrjes, Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se “Marrëveshja duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për ditët e pranisë në punë duke e detyruar në kompensimin e shumësi si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 45 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8250/2023, me datë 19.03.2024**

**Kryetarja e Kolegjit,**  
**Naime Ahmeti, d.v.**